



The JOSHA Demetrios Project: - Albanian

Authors:	Bujar Q. Bajçinovci
Submitted:	26. August 2017
Published:	27. August 2017
Volume:	4
Issue:	3
Affiliation:	University of Prishtina, Faculty of Civil Engineering and Architecture, Kosovo
Languages:	Albanian
Keywords:	Textbook, Monograph, Books as Open Online Content (BOOC), Demetrios of Phaleron, Alexandrina Library, Language: Albanian
DOI:	10.17160/josha.4.3.317

JOSHA

josha.org

**Journal of Science,
Humanities and Arts**

JOSHA is a service that helps scholars, researchers, and students discover, use, and build upon a wide range of content

International Academy of Science, Humanities and Arts

IASHA e.V. Freiburg, Deutschland

JOSHA Projekt Demetrios

*Libra dhe artikuj në të gjitha gjuhet
Libra me akses të hapur online – BOOC*

Duke filluar me numrin e korrikut 2017, **JOSHA** do të filloj së implementuari **Projektin Demetrios**. Projekti është emërtuar sipas Demetrit nga Phaleroni, nxënës i Theophrastus-it, dhe ka shumë të ngjarë të ketë qenë edhe nxënës i Aristotelit. Demetri ishte themeltar në krijimin e bibliotekës së lashtë të Aleksandrisë, sypozohet të ketë qenë biblioteka më e madhe dhe më e rëndësishme e botës së lashtë, e cila mbulonte të gjitha fushat e shkencës dhe të arteve, në shumë gjuhë të asaj kohe.

Është objktivi ynë të hapim **JOSHA**-në si bibliotekë me akses të hapur për të gjitha gjuhët dhe vendet. **JOSHA** fillimisht do të fokusohet në botimin e teksteve shkollore dhe universitare në çdo fushë të shkencës dhe të arteve, për të gjithë studentët dhe lexuesit gjithëandje, me akses të hapur online. **JOSHA** do të publikojë tekste universitare në çdo gjuhë, pas vlerësimit adekuat nga ekspertët e fushës relevante, të gjuhës përkatëse. Bordi i **IASHA**-së dhe redaktorët e **JOSHA**-së, vlerësojnë se ekziston nevojë imediate për të siguruar qasje në tekste universitare me akses të hapur, sidomos për studentët dhe hulumtuesit nga vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, ku tekstet shkollore janë thjeshtë të papërballueshme për nga kostoja për shumicën e studentëve. Andaj, ne i inkurajojmë autorët, si dhe lexuesit gjithëandje që të aplikojnë dhe dorëzojnë falas tekstet e tyre për botim në **JOSHA**.

Fillimisht, këtë projekt do e fillojmë me monografinë në gjuhen Shqipe nga lëmia e Arkitekturës, autorë i së cilës është profesori Bujar Bajçinovci nga Kosova.

Akademia ndërkombëtare e shkencave, e shkencave humane dhe arteve (**IASHA** e.V.) me seli në Freiburg, botuesi i **JOSHA**-së, respektivisht, të gjithë anëtarët e Akademisë do të bëjnë përpjekje të veçantë për të mbështetur këtë projekt. Gjithashtu, ju inkurajojmë edhe Ju që ta përkrahni këtë nismë të rëndësishme duke ju bashkuar aktiviteteve filantrope të **IASHA**-së e.V. (<https://iasha.org>) apo duke e mbështetur me donacion **IASHA** e.V.

“...Ta përjetosh, se një qenie ka marrë frymë më lehtë, sepse ne kemi jetuar. Kjo është ndjenja e suksesit.” (Ralph Waldo Emerson, 1803 – 1882).




Figura nga O. Von Corven - Tolzmann, Don Heinrich, Alfred Hessel and Reuben Peiss. The Memory of Mankind. New Castle, DE: Oak Knoll Press, 2001, Public Domain, <https://commons.wikimedia.org/A>

Rreth JOSHA

Revista me akses tè hapur online “Journal of Science, Humanities and Arts – JOSHA”, është një platformë e re botuese në internet, me diversitet tè gjerë tè hulumtimeve tè rëndësishme dhe krijimtarisë nè tè gjitha fushat e shkencës, dhe tè arteve. JOSHA është revistë e Akademisë ndërkombëtare tè shkencave, dhe arteve (IASHA e.V.) me seli nè Freiburg, Gjermani.

Ne, nè JOSHA besojmë se: “ Njohuria që nuk komunikohet, është njohuri e cila tretët.” Andaj, mu për këtë, kemi themeluar revisten me akses tè hapur online, edhe atë falas për aplikim dhe botim, duke inkurajuar autorët, artistët, hulumtuesit gjithëandej që tè aplikojnë dhe prezantojnë njohurit e tyre për tu botuar nè JOSHA.

Deri tani (Gusht, 2017) kemi publikuar 4 vëllime, 16 numra, dhe mbi 120 artikuj. Aktualisht vëllimi i qasjes nè JOSHA përfshin mbi 190,000 shiqime/klikime dhe mbi 150,000 shkarkime nè muaj.

Diversiteti i autorësisë nè publikime tè JOSHA-së, përfaqësohet duke filluar nga studentët e magjistraturës, doktoraturës, artistët, shkencëtarët e deri tek laureatët e çmimit Nobel.

Në JOSHA, qasja mund të bëhet përmes linkut, www.josha-journal.org, apo nga ndonjë prej rrjeteve sociale: [Facebook](#) dhe [LinkedIn](#). JOSHA aktualisht është i indeksuar në [ROAD](#) (Directory of Open Access Scholarly Resources), [e-journal.org](#), dhe [Scilit](#).

Softueri botues i revistes JOSHA është zhvilluar nga JOSHA GmbH Software, dhe është i licencuar në Akademinë Ndërkombëtare të Shkencave dhe Arteve, IASHA e.V. Freiburg, Germany.